



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Ligji Nr. 05/L-112

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E TRAFIKUT URBAN  
PRISHTINË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E TRAFIKUT  
URBAN PRISHTINË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen e garancisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për realizimin e projektit në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të transportit urban për qytetarët e komunës së Prishtinës nëpërmjet përtëritjes së flotës së autobusëve.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

Ratifikohet Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës.

**Neni 3**  
**Dokumentet e bashkëngjitura**

1. Në Shtojcën e këtij Projektligji është e bashkëngjitur:

1.1. Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës;

1.2. Marrëveshja për hua ndërmjet NPK Trafiku Urban dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës; dhe

1.3. Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -112**  
**4 gusht 2016**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

---

**Kadri VESELI**